



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPŠTINE	
SKENDERAJ	
Nr.	
No.	02-060/01-0018540/26
Data.	
Data.	20.05.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit/Kabinet Predcednika/Office of the Mayor

Në mbështetje të Statutit të Komunës së Skenderajt si dhe nenit 9, pika 1/4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe Nr.03/2012 të MAPL-së, për KKSBB-në dhe nenit 7.3 të ligjit Nr.04/L-76 për Policinë; Kryetari i Komunës

THËRRET

Mbledhjen e dytë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2026, e cila do të mbahet më **28.05.2026** duke filluar nga ora **13:30** në sallën e Bordit të Drejtorëve në ndërtesën e komunës.

Për këtë mbledhje propozon këtë:

REND DITE

1. Hapja e mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i situatës së sigurisë gjatë muajve të fundit;
4. Diskutim mbi sigurinë në shkolla dhe rreth tyre;
5. Parandalimi i dhunës në familje;
6. Siguria në komunikacion;
7. Të ndryshme.



Ekstrakt nga proceverbali i mbledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Datë: 31.03.2026

Vendi: Salla e Bordit të Drejtorëve, në ndërtesën e Komunës

Të pranishëm në këtë mbledhje:

Kryetari i Komunës Sami Lushtaku dhe anëtarët e KKS-së: Agim Idrizaj (Policia e Kosovës), Kastriot Duraku (DKA), Arber Geci (DShP), Sokol Hoxha(DShP), Avdi Jakupi(Përfaqësues i prindërve), Gordana Tomic (përfaqësuese e komunitetit serb), Fatmir Balaj(ZKK), Nedelko Kovacevic (OKZP), Arsim Haziraj (OJQ-Handikos), Sefadin Radonqiq (PKB), Qefsere Dautaj-Uka(ZBGJ), Ymerdin Hasani (FSK), Valon Haliti (DI), Arbnor Sinani (BIK), Amir Lushtaku (Koordinator).

Në këtë mbledhje u diskutuan këto pika:

1. Hapja e mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i planit të punës të KKS-së për vitin 2026;
3. Diskutim mbi situatën rreth vërshimeve gjatë muajit janar dhe masat në lidhje me vërshimet eventuale;
4. Diskutim rreth sigurisë në komunikacion, sigurisë në shkolla, dhe çështjeve të tjera të sigurisë;
5. Diskutim mbi menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës, identifikimin e deponive ilegale dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për parandalimin e tyre;
6. Të ndryshme

Kryetari: Përshëndetje të gjithëve, është takimi i parë me këtë përbërje, kënaqësi e madhe që kam këtu Komandantin e Policisë, FSK-në dhe pakicat. Mendoj që do të kalojmë mirë, duhet komunikimi ynë i përbashkët sepse jetojmë në një vend ku kemi edhe pakica, respekt gjithmonë për pakicat, kemi pasur takime të shpeshta më herët, shumë shpejt do e bëj një takim në Syriganë dhe Bajë.

Ne e kemi një rend dite dhe planin e punës e keni secili përpara, e kemi dërgu edhe në email adresë.

Kush është për rendin e ditës?

Konstatojë që është miratuar rendi i ditës dhe Plani i Punës i KKS-së

Takimi im i parë, për mua është e rëndësishme që po takohemi fillimisht dhe që kemi mundësi me i diskutu problematikat tona të përgjithshme që i ka Komuna e Skenderajt.

Pas miratimit të rendit të ditës dhe planit të punës, kalojmë të **pika 3 e rendit të ditës: Diskutim mbi situatën rreth vërshimeve gjatë muajit janar dhe masat në lidhje me vërshimet eventuale.**

Në komunën tonë kemi vërshime dhe shpesh kemi problematika me këtë fenomen natyror. Edhe pse ne kemi pasur nevojë shpesh për FSK-në por nuk na janë përgjigje si duhet, nuk e di pse, kisha pas dëshirë gjatë diskutimit, nëse kanë ndonjë informatë me siguri na e jepin, nëse nuk kanë, në takimin tjetër kur të diskutojmë, po besoj që pak a shumë na informojnë pse nuk janë ardhë me kohë, pse nuk na kanë ndihmu, sepse unë e di që FSK-ja e ka edhe njësi që është për rastet emergjente, që duhet me çdo kusht me marrë pjesë atëherë kur kemi nevojë.

Ymerdin Hasani: Me duket se kam komunikuar me ju, shef i kabinetit Amir, ne veçse kemi qenë në komunikim të vazhdueshëm, por faktikisht ne jemi tërë kohën në koordinim me AME dhe në momentin që ka dalë AME jashtë dhe i ka bërë vlerësimet e veta, prej tyre kemi pranuar email që nuk ka nevojë për intervenim, për atë arsye ne emailin veçse e kemi përcjellë dhe krejt informatat çka ne i kemi pasur i kemi përcjellur të shefi i kabinetit, të Amiri. Për këtë arsye edhe nuk kemi dalë në intervenim sepse sipas të dhanave prej AME nuk ka pasur nevojë për me dalë në terren.

Kryetari: Faleminderit. Dua ta falënderoj Policinë e Kosovës që kanë bërë një punë të shkëlqyeshme, mendoj që ne duhet që me çdo kusht me i dalë njëri-tjetrit në ndihmë kur kemi nevojë dhe po besoj që edhe Policia edhe FSK-ja edhe qytetarët tjerë.

A ka dikush tjetër diçka për këtë pikë?

Sokol Hoxha: Faleminderit kryetar, fjala përshëndetëse. E para, temat që kam me i trajtu, janë të rëndësishme edhe për sigurinë në Komunë, për emergjencat që munden me na ndodhë edhe për sigurinë në shkolla e të gjitha këto, sepse unë e kam parë edhe Planin e Punës dhe temat janë shumë adekuate.

Meqenëse u përmend pika tre e rendit të ditës për vërshime, dua ta falënderoj edhe Zyrën për Komunikim me Media e cila në çdo kohë ka raportuar profesionalisht, ku të gjithë ne kemi informatë ku kemi vepru dhe çka kemi punu dhe qysh e kemi pasë situatën.

Unë e kam edhe një raport për atë se si e kemi pasur gjëndjen. Ne këtu në Planin Operativ Emergjent lokal i kemi tri faza: parandalimi dhe planifikimi i emergjencave, reagimi dhe rimekëmbja.

Ne në komunën tonë kemi problemin me lumin Klina i cili vërshon më së shumti, por i kemi edhe lumenjtë tjerë dhe ne rastet e tilla kemi të bëjmë me një territor me të gjerë, jo vetëm qytetin. Unë mendoj që kish qenë mirë nëse ndajmë buxhet për pastrimin e lumit Klina, ashtu siq e kemi për pastrimin e rrugëve gjatë dimrit dhe verës dhe atëherë ku është bërë pastrimi i shtratit të lumit me vazhdu me u mirëmbajtë me një kompani në kuadër të shërbimeve publike kjo e para, e dyta në qytet e kemi problemin me kanalizimet e reshjeve atmosferike, ato mbushen bllokohen dhe ujin nuk munden me përcjellë edhe këtu duhet me pasë në të ardhmen një kompani e cila i pastron ato, këto janë dy pika që ne duhet me ndërhy. Më shumë në nuk mundemi me të bëjmë se sa që kemi bërë me policinë, zjarrëfikësat, qytetarët, në këto dy parë vërshime që i kemi pasë. Kjo ishte në fazën e planifikimit.

Në reagim kemi qenë të kyçun të gjithë, Kryetari si përgjegjësi kryesor, Drejtorja e Shërbimeve Publike, pastaj edhe kompanitë private të cilat kanë bashkpunu vazhdimisht.

Këto janë masat që unë mendoj se ne të ardhmen duhet me qenë prioritet.

Pasojat e këtyre vërshimeve të datës 6 janar 2026 sipas Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve është rreth 502 mijë euro, në bujqësi, në ekonomi familjare, në biznese dhe vetura.

Ne si sektor i emergjencave dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike jemi duke kërkuar bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Drejtorinë e Arsimit e Kryqin e Kuq për një trajnim që kemi me e mbajhtë në shkollën e Tushilës, ku kemi me pa se si ne i tërheqim nxansat në rastet emergjente sidomos prej vërshimeve. Gjithashtu për mirëmbajtjen dhe pastrimin e lumit, rregullimin e shtratit me muri mbrojtës, me një shumë të parave të cilën ne nuk e kemi.

E dyta me KFOR-in Slloven, i kemi disa ekipe duke punuar, për me siguru donacione prej Bashkimi Evropian për mirëmbajtjen dhe rregullimin e lumit në Komunën tonë.

Çdo vit i bëjmë kërkesa edhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Planifikimit Hapësinor që të intervenojnë në këto probleme me lumenjë.

Kryetari: Faleminderit, dikush tjetër?

Agim Idrizaj: Fjala përshëndetëse. Unë i'u kisha referu pjesës dytë të pikës 3 lidhur me masat, për vërshimet eventuale meqenëse tash janë identifikuar të gjitha pikat e zeza, se ku mund të ketë vërshim dhe ku mund të del lumi nga shtrati, kish qenë mirë që me ndërmarrë masa preventive, që në vendet ku ka mbyllje/bllokim të shtratit me i pastru me kohë, në mënyrë që mos të merrëmi pastaj me pasojen por me eliminu shkakun dhe me kalu situatën me lehtë. Përndryshe në situatat e kalume po du me i falënderu të gjithë partnerët që kanë marrë pjesë në menaxhimin e vërshimeve të gjithë e kanë dhënë kontributin e vet, kërkoj edhe tash që në mënyrë të koordinume duke fillu nga identifikimi i problemit deri të zgjidhja e problemit me vepru bashkarisht.

Kryetari: Faleminderit shumë. Ne vërtetë jemi përballë me këtë problematikë edhe me herët por edhe ne dy rastet që na kemi mësuar shumë, po besoj që bashkë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Komandantin e Policisë dhe FSK-në dhe me ata që janë përgjegjës kemi me ia dalë.

A ka dikush tjetër diçka? Nëse jo, kalojmë në pikën e 4, të rendit të ditës.

Diskutim rreth sigurisë në komunikacion, sigurisë në shkolla, dhe çështjeve të tjera të sigurisë.

Këtu kemi më së shumti detyra dhe punë me Drejtorinë e Arsimit dhe me Komandantin e Policisë. E di që veprimet dhe ndarja e detyrave janë ato që i keni, por ajo që ne kemi dëshirë është të ketë me shumë kontrolla afër shkollave. Ne i kemi dy probleme në shkolla: Makinat që vozitin shpejtë, sidomos atë ku janë shkollat dhe një problem tjetër që edhe ju e dini është përdorimi i substancave narkotike, jo vetëm në Komunën tonë por në të gjithë Kosovën.

Ky është një rrezik për neve dhe pres më shumë mbikqyrje dhe punë nga drejtori i Arsimit, i shkollave, mësuesit, profesorët dhe ju keni më shumë mundësi atë.

Agim Idrizaj: Unë kryetar e falënderoj Drejtorinë e Arsimit, për kontributin e dhënë sa i përket sigurisë në shkolla sidomos në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve. Kemi bashkëpunim shumë të mirë për shkak se tash kanë ndryshu rrethanat, në të kaluarën kemi pasur problem në

raportimin e problemeve, njerëzit kanë hezitu, ndërsa tash na informojnë, na raportojnë dhe i paraqesin për zgjidhje. Kjo ka bërë që të kemi një situatë më të mirë.

Jemi në zbatim të një Plani Operativ “Siguria në Shkolla” plani parasheh angazhimin e resurseve policore në rroba civile dhe në uniformë, ata janë gjithmonë në kontakt me përfaqësuesit e shkollave, drejtorinë e arsimit dhe bashkarisht po i identifikojmë problemet dhe po i zgjidhim edhe me partneret tjerë si Qendra Sociale, mbrojtësit e viktimave. Megjithatë, kemi pasur raste por fati i mirë që janë identifikuar në kohë dhe tash vetëm po veprohet në parandalimin e tyre. Po ashtu kemi edhe prezencë policore në uniformë në shkolla, sidomos në shkollat më të mëdha. Mirëpo në do të jemi gati si partner ta rrisim prezencën, që me izolu çdo problem dhe të ndërmarrim masat e nevojshme ligjore. Ne jemi gati si institucion që me përkrahë çdo iniciativë që është e mirë dhe që i kontribon interesit të sigurisë.

Kastriot Duraku: Është i pakontestueshëm angazhimi dhe puna e Policisë së Kosovës, veçanërisht e policive me rroba civile, një pikë mbështetëse për shkollat dhe drejtorinë e arsimit. Problemin kryesor e kemi në shkollat fillore, si shkolla “Rifat Mëziu” për arsye se është fluksi më i madh i lëvizjeve dhe numri i nxënësve është më i madh, numëron diku mbi 100 nxënës dhe konsiderohen si më të rriur dhe ajo që kërkoj nga komandanti është shtimi i kontrollave dhe ndalja e makinave të shoferëve që vozitin nën moshën 18 vjeç. Po kemi nxënës që po vozitin dhe po kemi më shumë problem me prind të nxënës. Po hasim në jo-mirëkuptim. Kërkojmë që në momentin që ka nxënës që vozitin të mirren masat adekuatë.

Një pikë tjetër që kam një kërkesë bashkëpunimi është për shkollat e mëdha në Bashkësitë Lokale me u rrit niveli i kontrollave nga ana e policisë, në shkollën e Runikut, Llaushës etj.

Kryetari: Dikush tjetër?

Arbnor Sinani: Fjala përshëndetëse. Të çështja e sigurisë në kemi pasur disutime të xhamia ilegale më shumë, e që në këta muajt e fundit kemi pasur një prezencë të një personi nga Gjilani, i dënuar për terrorizëm, e që vjen pikërisht në këtë xhami ilegale dhe mban ligjerata, iftare. E ne aspektin fetar dhe të sigurisë natyrisht se ka me u komentuar si diçka e ran për neve edhe si qytetar edhe fetar, e koncepte të tilla janë të dëmshme për shkak se janë përtej vijes zyrtare që e kemi ne si Bashkësi Islame. Kemi qenë në vazhdimësi në komunikim me ju dhe me policinë për këtë shqetësim, fatmirësisht vetëm një të tillë, por dita ditës nr. është duke u shtuar e që paraqet rrezik se çka ligjërohet e proklamohet atë.

Si Bashkësi Islame, sipas hapësirës që mund të kemi, mund të japim kontributin tonë me aq mundësi sa kemi, në jemi gati dhe mos na kurseni, në fushatat edukuese e tematikat e rëndësishme të veçantë.

Kryetari: Faleminderit shumë. Dikush tjetër?

Qefsere Dautaj: Fjala përshëndetëse. Deshta të ndërlihdëm të pika siguria në shkolla. Shqetësim i joni është që në Skenderaj ka raste që kanë ra pre e trafikimit me qenie njerëzore, e kemi diskutu edhe mekanizim kundër dhunës dhe është shqetësim i madh se na e dim si rast që një vajzë e re që ka ra viktim e trafikimit me qenie njerëzore. Është problematik shumë e madhe që duhet të jemi me vigjilent dhe rrjetëzimin të mund ta zgjidhim dhe të ketë efekt. Sa i përket aktiviteteve

edukative kundër dukurive negative Njësia për të Drejtat e Njeriut zakonisht mbanë aktivitete siç janë 16 ditët e aktivizmit por edhe kur i kemi mundësitë përmes ndonjë donatori mbajmë aktivitete të vazhdueshme kundër këtyre dukurive.

Valon Haliti: Fjala përshëndetëse. Desha të ndërlihem të çështja e sigurisë në komunikacion edhe pse e ndajmë përgjegjesinë se bashku me policinë. Ne po e presim përmirësimin e kushteve atmosferike dhe me fillu me shenjëzimin vertikal dhe horizontal në qytet krejt kjo në funksion të rritjes së sigurisë në trafik por edhe nëpër fshatra sepse është kërkesë e banorëve që me pasë aktivitet të shtuar edhe në Bashkësi Lokale sepse ka qarkullim të automjeteve të pa regjistruar dhe shoferëve pa leje të qarkullimit rrugor.

Të çështja e mezxhidit, e kemi diskutuar edhe në të kaluarën, ne jemi munduar që ta shtrojmë autoritetin tonë, kemi marrë info që ajo nuk është në kuadër të Bashkësisë Islame në Skenderaj, apo BIK-ut. Kam pasur takim me KFOR-in britanik, ata ishin të shqetësuar. Kemi pranuar edhe ankesë nga banorët që banojnë afër vendeve ku ata ligjerojnë, por kjo i takon policisë për prishje të rendit dhe qetësisë publike.

Edhte të pjesa e sigurisë në shkolla, për parandalimin e shitje të cigareve për fëmijët nën moshë, ne vazhdimësi me policinë kemi zhvilluar aktivitet inspektues, kemi raste që kemi shqiptuar gjoba ndaj shitësve që i'u kanë shitur cigare fëmijëve. Vazhdon si shqetësim, mirëpo jemi duke e përcjellur situatën, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

Agim Idrizaj: Ne kemi vepruar bashkarisht lidhur me mesxhidin e kemi identifikuar si rast, i kemi përcjellur të gjitha informacionet të njësitë adekuate në Prishtinë. Mirëpo ne do e përcjellim si rast bashkarisht me drejtorinë e inspektoratit.

Kryetari: Faleminderit. Në të gjithë bashkarisht duhet të bashkëpunojmë si drejtoritë, policia, bashkësia islame për sigurinë e fëmijëve tonë edhe përmes mesazheve edhe përmes veprimeve konkrete në terren. Po besoj që kemi me gjetë një gjuhë të përbashkët dhe ku kemi mundësi dhe lejohet ta bëjmë punën tonë.

Kryetari: Nëse nuk ka diçka tjetër, kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës **Diskutim mbi menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës, identifikimin e deponive ilegale dhe bashkëpunimin ndër-institucional për parandalimin e tyre**

Pikë e rëndësishme, problemi i deponive ilegale një problem i madh në komunën tonë, por na duhet ndihma e policisë, me një aktivitet më të madh në identifikimin e rasteve të hudhjes së mbeturinave.

Po besoj që bashkarisht, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoratit, policia kemi me fillu me i zgjidhë problemet, qoftë me tërheqje të vërejtjes, qoftë me gjoba, kemi me mbrri me i vetëdijësu qytetarët për këtë problem. Ligji duhet të funksionojë për të gjithë njëjtë e barabartë në gjithë komunën tonë. Atu ku kemi mundësi të vendosim kamera, sepse kemi telashe buxhetore.

A ka dikush diçka?

Arber Geci: Fjala përshëndetëse. Me 22 prill është Dita e Tokës, deri tash i kemi identifikuar 86 deponi ilegale në të gjithë territorin e Komunës tonë, në të gjitha fshatrat, me 22 prill kërkoj më

shumë bashkëpunim edhe prej FSK-së edhe prej policisë, arsimit, kam pasur takim me KFOR-in turk kanë me na u bashkangjitur në largimin e këtyre deponive, pasi t'i largojmë këto deponi që ju me prezencën më të madhe në terren me na lajmëru ku ka raste që na me ndërmarrë masa sepse ndryshe është problem me i identifiku rastet e atyre që po i hedhin mbeturinat në vendet jo të duhura sidomos kur po kemi vërshime.

Valon Haliti: Komandant, ju e keni monitorimin e kamerave nëpër qytet, mundësisht ku ka raste me na njoftu për hudhësit e mbeturinave dhe pastaj ne i ndërmarrim masat.

Agim Idrizaj: Kamerat janë të komunës, por ne jemi të gatshëm ku ka nevojë t'i përdorim, të bashkëpunojmë, me i përdor dhe i identifikojmë dhe iu njoftojmë.

Arbnor Sinani: Të pjesa e kamerave nëse ka nevojë, sepse edhe xhamiat tash kanë kamera jashtë, nëse ka nevojë me pasë çasje, për shkak të sigurisë së përgjithshme, nëse ndonjë herë kish me shërby, nuk ka asnjë problem për shfrytëzim.

Arber Geci: Komandant edhe një çështje qeshmja e qytetit që është mbrapa saj është një depo ne e ndrojmë drynin e saj që dy-tre here, taksistat prapë po e thejnë dhe po e shfrytëzojnë për nevojat e tyre është mirë me pa se për çfarë është problemi.

Agim Idrizaj: Do ta kemi parasysh, sepse e kemi obligim.

Kryetari: Faleminderit. Dikush tjetër rreth kësaj pike? Ne i kemi dy përfaqësues të minoritetit serb, a keni diçka, ndonjë shqetësim që ne duhet me e ditë?

Nedeljko Kovacevic: (përkthyesi) Fjala përshëndetëse. Edhe ne kemi pasur problem me vërshimet dhe dëmeve nga vërshimet, kemi probleme rreth intervenimit të rrugës se re, ku është dëmtuar një rrugë, është i nevojshëm një intervenim për tu bërë një mbrojtje apo pengesë që mos me u zgjeru ai dëmtim. Gjithashtu ka problem edhe për mbeturinat ilegale, që hudhen vend e pa vend edhe përkundër asaj që Komuna i kryen obligimet e veta për largimin e mbeturinave, njerëz të pa përgjegjshëm vazhdojnë në hudhjen e mbeturinave vend e pa vend, I bashkohëm kërkesës së kryetarit, që të ndërmerren masat për ndëshkimin e personave të papërgjegjshëm dhe të arrihet qëllimi i përbashkët për mbrojtjen e ambientit.

Gordana Tomic: Fjala përshëndetëse: Ndodhë që kamioni që bartë mbeturinat të prishet dhe njerëzit i vendosin mbeturinat në një përrua apo gropë, i ndezin, duke shkaktuar ndotje. Për fat të keq ka njerëz edhe pse është shporta e mbeturinave ata i hudhin jasht tyre.

Arber Geci: Sa i përket çështjes së mbeturinave, kur ka prishje të kamionit, grumbullimi i mbeturinave bëhet çdo dy javë.

Kryetari: Faleminderit. Unë se shpejti do e bëj një vizitë në fshatin Syriganë dhe Bajë, do e shoh rrugën.

Nëse nuk ka diçka tjetër e mbylli takimin edhe njëherë faleminderit shumë për prezencën.

Shihemi në takimin e radhës.

Procesmbajtës/e: Besjana Thaçi